

PLANI EKONOMIK LOKAL PËR  
KATEGORITË E CENUESHME TË  
QYTETARËVE, TË  
RIATDHETSUARVE DHE  
ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË  
TYRE PËR KOMUNËN E  
KUMANOVËS DHE KOMUNËN E  
LIKOVËS

Ky publikim është përgatitur si pjesë e projektit “Rruga drejt rezistencës dhe riintegritit të familjeve të cenueshme në komunitet”, i cili zbatohet nga një konsorcium i organizatave: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Nexus - Koncepti qytetar, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP , Horizon Civitas dhe Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi global i angazhimit dhe rezistencës së Komunitetit-GCERF.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e GCERF ose organizatave të tjera që e zbatojnë programin.

Autor: Goran Veleski

prill-maj 2022

## Përmbajtja

Rezyme.....	3
Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Kumanovës de Komunën e Likovës.....	6
Të dhëna themelore për Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës.....	7
Komuna e Kumanovës .....	7
Komuna e Likovës .....	8
Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre .....	8
Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat.....	10
Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës .....	11
Orientimi në karrierë .....	11
Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin.....	12
Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore .....	13
Vetëpunësimi .....	13
Rekomandime .....	14

# Plani ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre për Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës

---

## Rezyme

Luftëtarët e huaj terroristë (të riatdhesuarit), si persona që banonin në zonën e konfliktit në Irak dhe/ose Siri dhe më pas u kthyen në Evropë, përfaqësojnë një rrezik potencial për shoqërinë. Republika e Maqedonisë së Veriut, si shumica e vendeve evropiane, përballet me sfidën e riintegritit të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre si kategori e veçantë e cenueshme e qytetarëve.

Në Maqedoni, ekziston një vullnet i qartë politik për rëndësinë e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër të terrorizmit. Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut formoi Komitetin kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, i cili është përgjegjës për koordinimin e punës së institucioneve në vend dhe në nivel ndërkombëtar dhe përfshirjen aktive të organizatave qytetare dhe institucionet arsimore në zbatimin e programeve të saj. Komiteti kombëtar i koordinon aktivitetet e parashikuara në Strategjinë kombëtare për luftën kundër terrorizmit (2018-2022), Strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (2018-2022) dhe planet e veprimit për to, si dhe Planin kombëtar për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin të të riatdhesuarve nga ushtritë e huaja dhe familjet e tyre (gra dhe fëmijë), së bashku me procedurat operative.

Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me inkriminimin e akteve të terrorizmit dhe veprimtarinë e luftëtarëve të huaj terroristë parashikohen në Kodin penal, Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, dhe Ligji për ekzekutimin e sanksioneve parashikon dispozita që rregullojnë risocializimi i personave të dënuar, përfshirë të riatdhesuarit.

Sipas Raportit të fundit të BE-së për progresin e vendit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka një kornizë ligjore për ballafaqimin me luftën kundër krimin të organizuar, e cila kryesisht është në përputhje me standardet evropiane, por nevojiten përmirësime në aspektin e masave për parandalimin e terrorizmit, d.m.th. nevojiten programe sistematike, të qëndrueshme,

gjithëpërfshirëse dhe relevante për riintegrim, risocializim dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj terroristë të rikthyer bazuar në një proces transparent që përfshin të gjithë aktorët relevantë.<sup>1</sup>

Të gjitha masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet bazohen në detyrimet e Planit kombëtar dhe procedurave për risocializimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të riatdhesuarve nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të miratuara nga Qeveria, koordinimin dhe zbatimin e të cilit e ka Komiteti kombëtar kompetent për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Riintegrimi është një proces afatgjatë dhe i shumanshëm, përmes të cilit të riatdhesuarit do të kenë mundësinë të riintegrohen në shoqëri, të ndihen si pjesë e shoqërisë, me synimin për t'u bërë anëtarë aktivë të jetës ekonomike, kulturore, civile dhe politike të vendit.

Përrjashtimi social, marginalizimi dhe varfëria janë sfidat me të cilat përballen të riatdhesuarit pas kthimit në vendin e tyre. Qasja në shërbimet sociale, punësimi, arsimit dhe strehimi janë pika kyçe mbi të cilat duhet punuar për të riintegruar në mënyrë efektive këto grupe të synuara.

Procesi i integritit ekonomik të kategorive të cenueshme të qytetarëve sjell një sërë sfidash, veçanërisht kur bëhet fjalë për të riatdhesuarit që tashmë po përballen me përjashtimin social dhe marginalizimin. Për të siguruar riintegrimin e suksesshëm të këtyre personave, nevojitet bashkëpunimi i përbashkët i të gjithë aktorëve social, duke filluar nga organet e sigurisë shtetërore, Komiteti kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, ministritë kompetente, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore etj. e deri te komunat, shkollat dhe familja. Media ka një ndikim të madh në ndërgjegjësimin e publikut, sepse mënyra se si ato informojnë dhe përdorimi i termave të duhur varet nga mënyra se si këta njerëz do të prezantohen dhe do të pranohen në komunitetet e tyre.

Në vitin 2020, Instituti për dialog strategjik kreu hulumtime mbi qëndrueshmërinë e komunitetit në Kumanovë, si pjesë e aktiviteteve rajonale të Rrjetit të qyteteve të fuqishme (Strong Cities Network (SCN)) në Kumanovë, për të kuptuar më mirë dinamikën lokale të qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Të dhënat dhe gjetjet e këtij studimi do të jenë baza për aktivitetet e mëtejshme të Ekipit të veprimit në komunitet të përshkruara në Planin lokal të veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Hulumtimi tregon se popullata e Kumanovës është relativisht rezistente, me dallimet më të mëdha në rezultatet e rezistencës që bazohen në moshën e individit dhe lagjen ku jetojnë, dhe se qëndrueshmëria e komuniteteve në Kumanovë ndikohet më së shumti nga besimi i tyre në institucionet publike. Të dhënat e sondazhit tregojnë se ka një korrelacion pozitiv midis besimit

---

<sup>1</sup> Raport në hije mbi strategjitë ekzistuese dhe kornizën ligjor përkatës për parandalimin dhe pengimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë të riatdhesuar dhe familjeve të tyre, Studim mbi situatën fillestare periudhën 2018 - 2021, SHOQATA QYTETARE "NEKSUS - KONCEPT CIVIL" - Shkup, 2022

të publikut në aftësinë e pushteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare për t'u marrë me urrejtjen dhe polarizimin, dhe rezistencën e tyre.

Instituti për dialog strategjik ka identifikuar një sërë rekomandimesh praktike për përmirësimin e programeve lokale në Kumanovë, duke përfshirë:

- Aktivitetet duhet të përcaktohen saktësisht për të synuar në mënyrë specifike kategoritë e cënueshme të qytetarëve.
- Aktivitetet duhet të synojnë të përmirësojnë besimin në institucionet (përfshirë zbatimin e ligjit) krahas përpjekjeve ekzistuese për të lidhur bashkësitë etnike dhe fetare.
- Përfshirja e komunës, shkollave dhe institucioneve fetare duhet të jetë me prioritet dhe të publikohet mirë.

Të dhënat nga ky hulumtim tregojnë se në Komunën e Kumanovës publiku ka besim në mekanizmin institucional, i cili në vazhdimësi duhet të forcojë kapacitetet e tij për të ofruar mbështetje gjatë zbatimit të programeve për riintegrim, risocializimin dhe rehabilitimin e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Veprimi i planifikuar dhe monitorimi i vazhdueshëm janë çelësi për riintegrimin e suksesshëm ekonomik dhe procesi duhet të përfshijë aktivitete të tilla si identifikimi i sfidave me të cilat përballet në tregun e punës, orientimi në karrierë përmes këshilltarëve për karrierë, forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive të lidhura me punësimin, punësimi i subvencionuar dhe trajnimi në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose kompani me përgjegjësi shoqërore, dhe/ose vetëpunësim.

Kategoritë e cënueshme të personave, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në Komunën e Kumanovës dhe Likovës mund të trajnohen për punësim në sektorët ekonomikë ku ka kërkesë për punë, si: tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, prodhimtaria, ndërtimtaria, transporti dhe magazinimi, etj. Fokusi duhet të jetë në profesionet për të cilat ka kërkesë për punësim të punëtorëve në rajonin verilindor, si teknik mekanik, teknik ndërtimi, administrator, operator sistemi, operator teknik kimik, teknik elektrik, teknik farmaceutik, shitës, rrobaqepës, këpucar, kamarier, saldator, ndihmës saldator, bravandreqës, shofer kamioni, bukëpjekës, kuzhinier, banakier, punëtor ndërtimi, punëtor bujqësie etj.

Subjektet përgjegjëse për realizimin e integritit ekonomik të të riatdhesuarve dhe familjeve të tyre në nivel lokal janë Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës, Qendra për punësim Kumanovë, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale të shoqërisë civile me mision social (ndërmarrjet sociale), ofruesit lokal të trajnimeve të verifikuara për të rriturit, Qendra për punë sociale-Kumanovë dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal.

## Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenushme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës

Plani ekonomik për riintegrim të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në shoqëri në Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës është përgatitur duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar në mënyrë sistematike informacionet në dispozicion.

Hulumtimi kishte për qëllim kuptimin e kontekstit në vend në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe prioritetet dhe tendencat e riintegrit ekonomik të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Po aq e rëndësishme, u identifikuan gjithashtu boshllëqet me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre që duhet të adresohen gjatë riintegrit të mëtejshëm ekonomik.

Aktivitetet përfshijnë analizën e literaturës ekzistuese, analizë e të dhënave dytësore dhe krijimin e një liste referimi në mënyrë që të gjitha dokumentet të jenë të organizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

Analiza e literaturës ekzistuese relevante për riintegrimin ekonomik përfshin një rishikim të rregulloreve ekzistuese, dokumenteve strategjike, planeve të veprimit dhe operacionale, raporteve për zbatim, teksteve gazetareske, etj. Gjithashtu u rishikua literatura shkencore nga praktikantët në shtetet e tjera dhe komunitetet lokale që përballen me këtë problem.

Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese, filloi analiza e të dhënave të disponueshme publike, si të dhëna demografike, ekonomike, sociale, të dhëna arsimore, si dhe të dhëna nga tregu i punës. Të dhënat janë përdorur për të perceptuar situatën dhe për të propozuar politika/masa për riintegrimin ekonomik, të bëra në bazë të të dhënave.

Gjatë përgatitjes së Planit ekonomik për riintegrim në nivel lokal, janë marrë njohuritë nga drafti i hulumtimit për mundësitë e tregut të punës, i cili është realizuar në tranzicionin para përgatitjes së planeve ekonomike.

## Të dhëna themelore për Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës

### Komuna e Kumanovës

Rajoni verilindor përfshin gjashtë komuna në pjesën verilindore të Republikës së Maqedonisë (Likovë, Kumanovë, Nagoriçan i Vjetër, Kratovë, Rankovcë dhe Kriva Pallankë) dhe shtrihet përgjatë kufijve me Kosovën, Serbinë dhe Bullgarinë, d.m.th. lumenjtë Pçinja dhe Kriva Reka.

Komuna e Kumanovës është komunë multietnike dhe multikulturore, e përbërë nga maqedonas (60,47%), shqiptarë (25,80%), serbë (6,67%), romë (5,71%) dhe grupe të tjera (1,35%). Si rezultat i këtij diversiteti, marrëdhëniet e mira ndërmjet komuniteteve janë vendimtare për paqen dhe zhvillimin.

Komuna e Kumanovës gjendet në kryqëzimin e dy korridoreve më të rëndësishme në vend (Korridori 8 – Korridori 10). Për nga numri i popullsisë, Kumanova është komuna më e madhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila ka 105.484 banorë, nga të cilët 25.771 janë të rinj të moshës 15 deri në 30 vjeç (sipas regjistrimit të fundit të vitit 2002, të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave).

Komuna e Kumanovës zë një sipërfaqe prej 509,48 km<sup>2</sup>, kurse në komunën e Kumanovës gjendet qyteti i Kumanovës dhe fshatrat: Agino Selo, Bedinje, Beljakovc, Biljanovc, Brzak, Vakëv, Vinçe, Gabresh, Konjare e Epërme, Gradishte, Dëlga, Dobroshane, Dovezence, Konjaree Poshtme, Zhivinje, Zubovcë, Jaçincë, Karabiçane, Kleçevce, Kokoshinjë, Kolicko, Kosmatac, Kutlibeg, Kuçkarevo, Këshanje, Llopatë, Lubodrag, Murgash, Novo Sellë, Novoseljane, Orashac, Pezovë, Proevcë, Pçinjë, Rezhanovcë, Reçicë, Romanovcë, Skaçkovcë, Sopot, Studena Bara, Sushevë, Tabanovcë, Tromegjë, Umin Dol, Çerkez, Çetircë dhe Shuplji Kamen.

Struktura e popullsisë në Komunën e Kumanovës është heterogjene, jo vetëm në qytet, por edhe në pjesën më të madhe të zonave rurale, ku jeton një popullatë e disa nacionaliteteve dhe grupeve etnike, me strukturë të ndryshme arsimore, moshore dhe gjinore, me zakone, fe dhe zakone të ndryshme, profesione të ndryshme dhe karakteristika të tjera. Komuna e Kumanovës është komunë multietnike dhe multikulturore, e banuar me maqedonas 59,58%, shqiptarë 26,44%, turq 0,28%, romë 4,03%, vllahë 0,14%, serbë 8,59%, boshnjakë 0,02% dhe të tjerë 0,64%.

Në Komunën e Kumanovës ekzistojnë pesë shkolla të mesme dhe shtatëmbëdhjetë shkolla fillore, me institucionet e tyre rajonale.

Për shkak të historisë së pasur të qytetit dhe rrethinës së tij, në Kumanovë ka një numër të madh të monumenteve kulturore-historike.



## Komuna e Likovës

Komuna e Likovës ndodhet në Maqedoninë e Veriut dhe përfshin 22 fshatra në shpatet e Karadakut të Shkupit dhe pjesën maqedonase të luginës së Zheligovës, përgjatë rrjedhës së Lumit të Likovës, një degë e djathtë e Lumit të Kumanovës. Qendra e komunës është fshati Likovë. Komuna shtrihet në një sipërfaqe prej 267,82 km<sup>2</sup>, me një dendësi popullore prej 101,03 banorë për km<sup>2</sup>. Popullsia në Komunën e Likovës është 30.367 banorë, shumica e të cilëve janë shqiptarë (97%).

Komuna e Likovës përbëhet nga 22 fshatra: Alashevcë, Belanovc, Vaksincë, Vishticë, Glazhnjë, Goshincë, Dumanovcë, Zllokuçane, Izvor, Likovë, Llojan, Mateç, Nikushtak, Opajë, Orizarë, Hotël, Rankovc, Ropajcë, Runicë, Sllupçan, Strazhë dhe Strimë.

Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në Komunën e Likovës.

Problemet prioritare me të cilat ballafaqohet komuna janë: vetëdija e ulët për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, mungesa e kujdesit adekuat shëndetësor në zonat rurale, veçanërisht në zonat malore, mungesa e transportit të organizuar për nxënësit nga vendet më të largëta, mungesa e fondit të dedikuar për zhvillim dhe mbështetje për të rinjtë, të rinjtë nuk janë mjaftueshëm aktivë në komunë, nuk janë mjaft të motivuar, mungesë burimesh financiare për realizimin e projekteve.<sup>2</sup>

## Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

Riintegrimi si koncept nënkupton një sërë aktiviteteve sistematike që realizohen për riintegrimin në shoqëri të individit, i cili për disa arsye është marginalizuar prej saj. Për këtë qëllim, zhvillohen programe specifike që përfshijnë mbështetje terapeutike dhe psikologjike, ofrimin e arsimit, trajnimin profesional, punësimin, sportin dhe ushtrimet fizike, qasjen në aktivitetet kulturore, shëndetin dhe kujdesin dhe promovimin e marrëdhënieve sociale. Programe të tilla zbatohen përmes mentorimit social, i cili synon të ndryshojë perceptimet për nevojat e të riatdhesuarve.

---

<sup>2</sup> Propozim iniciativa buxhetore është përgatitur në kuadër të projektit “Përmes lenteve të grave: iniciimi i politikave dhe nismave buxhetore, monitorimi i zbatimit të planeve lokale të veprimit mbi barazinë gjinore” financuar nga Bashkimi Evropian, 2021

Fjala është për një proces shumë të ndjeshëm përmes të cilit mund të shfaqen një sërë problemesh, por veprimi sistematik dhe vullneti për bashkëpunim i të gjitha subjekteve shoqërore të përfshira mund të japë rezultatet e dëshiruara. Veprimi sistematik imponon domosdoshmërisht nevojën e përgatitjes së një Plani dhe Programi për integrimin e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre, i cili do të parashikojë në detaje aktivitetet që duhet të ndërmerren për të realizuar me sukses procesin e planifikuar.

Planifikimi participativ, përkatësisht pjesëmarrja e përfaqësuesve nga pushteti kombëtar dhe lokal, liderë të komunitetit, ish-luftëtarë do të jetë me rëndësi të madhe për zhvillimin dhe zbatimin me sukses të planeve dhe programeve. Përfshirja e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre në procesin e planifikimit do t'i japë procedurës një ton realist, duke përjashtuar abstraktitetin e aktiviteteve të planifikuara.

Një ekip multidisiplinar (punëtorë socialë të trajnuar, psikologë, pedagogë, avokatë, persona fetarë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile) që ka njohuri eksperte për këtë problem, trajnimi i stafit mësimdhënës që do të përfshihet në procesin arsimor, psikologë dhe mjekë të trajnuar shkollor janë të një rëndësie thelbësore për riintegrim të suksesshëm.

Para se të fillohet me zbatimin e Planit ekonomik lokal për riintegrimin në shoqëri të të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Kumanovës, është e nevojshme të zbatohen disa komponentë të planit të përgjithshëm për riintegrim, si parakushte të rëndësishme që personi të fitojë një arsimim dhe të konkurrojë në tregun e punës, gjegjësisht sigurimi i dokumentacionit personal, ushtrimi i të drejtës për mbrojtje sociale si mbështetje financiare mujore sipas Ligjit për mbrojtjen sociale, sigurimi i kushteve rezidenciale për strehim nëse është e nevojshme, ofrimi i kujdesit shëndetësor dhe mbështetjes psikologjike.

Sfida e radhës është punësimi dhe qasja në tregun e punës, si një nga shtyllat e çdo politike për emancipimin e grupeve të cënueshme. Kushtet e këqija ekonomike janë një nga arsyt kryesore për rritjen e migrimit të parregullt.

Plani për riintegrimin e të riatdhesuarve dhe familjarëve të tyre është një dokument zhvillimi i përpiluar mbi bazën e të dhënave aktuale dhe prioriteteve të përcaktuara në momentin e miratimit të tij. Plani është fleksibël, i përditësuar vazhdimisht dhe i përshtatur nevojave të përdoruesve dhe tendencave aktuale të mbrojtjes sociale në shoqëri.

Në kuadër të këtij Plani ekonomik lokal janë planifikuar masa dhe aktivitete me të cilat do të menaxhohet me sukses procesi integruar dhe ky dokument do të japë një pasqyrë të veçantë të masave dhe aktiviteteve që duhet të zbatohen në drejtim të integritit ekonomik, gjegjësisht përfshirjes aktive të grupeve të synuara në tregun e punës. Dokumenti do të përfshijë gjithashtu kualifikimet dhe aftësitë arsimore që duhet të fitojnë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre, si një parakusht i rëndësishëm për gjetjen e punësimit, por edhe për integrim të suksesshëm.

## Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat

Integrimi ekonomik i kategorive të cënueshme të qytetarëve, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, në Komunën e Kumanovës dhe Komunën e Likovës planifikohet të realizohet duke ofruar mundësi për punësim dhe të ardhura. Mënyra më e mirë për integrimin ekonomik është t'u ofrohet trajnim profesional dhe punësim, i cili do t'u mundësojë të forcohet ekonomikisht dhe në aspektin social. Sigurimi i shpejtë i kushteve të jetesës është një parakusht për fillimin e procesit drejt punësimit të qëndrueshëm të tyre. Në procesin e integritit ekonomik, barrierat e tregut të punës duhet të kapërcehen duke ofruar informacion për karrierën, orientim për arsimin formal dhe joformal, trajnime në klasë dhe/ose në vendin e punës, zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës, ndihmë gjatë kërkimit të punë, punësim i subvencionuar dhe/ose vetëpunësim.

Integrimi ekonomik do të zbatohet me mbështetjen e një këshilltari për karrierë dhe realizohet në tre faza:

- Sigurimi i kushteve bazë për një jetë të denjë duke iu përshtatur jetës në shoqëri dhe mundësimi i kushteve për aktivizim në tregun e punës.
- Aktivizimi i tregut të punës dhe trajnimi në përputhje me kërkesat e punëdhënësve.
- Punësimi nëpërmjet subvencionimit të pagave ose vetëpunësimit me grant në pajisje dhe/ose materiale.

Të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre duhet të marrin ato shërbime dhe masa të disponueshme që i përshtaten më mirë nevojave të tyre individuale, dhe në situata të caktuara dizajni i një shërbimi ose mase të caktuar duhet t'u përshtatet nevojave të një individi të caktuar. Po kështu, përfshirja e grupeve të synuara në hartimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe masave në nivel kombëtar dhe vendor mund të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të masës.

Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës i takojnë rajonit verilindor, i cili është një nga rajonet më të pazhvilluara në vend. Në këtë rajon ka kërkesë për fuqi punëtore në sektorët e mëposhtëm: tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, ndërtimtari, transporti dhe magazinimi dhe bujqësia. Trajnimi për punësim në këta sektorë ekonomikë do të rrisë punësueshmërinë e kategorive të cënueshme të personave, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Aktorët kryesorë në integrimin ekonomik të të riatdhesuarve dhe familjeve të tyre në nivel lokal janë Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës, Qendra për punësim Kumanovë, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale të shoqërisë civile me mision social (ndërmarrjet sociale), ofruesit vendorë të trajnimeve të verifikuara për të rritur, Qendra për punë sociale-Kumanovë dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal.

Aktivitetet kryesore për fuqizimin ekonomik dhe punësimin për të riatdhësuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre kërkojnë një qasje holistike në masat dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit, duke përfshirë masat e mëposhtme:

### Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhësuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës

Hapi i parë në integrimin ekonomik përmes punësimit është njohja e barrierave me të cilat përballen kategoritë e cenueshme në tregun e punës. Ekzistojnë disa pengesa të mundshme si: mungesa e arsimit adekuat, mungesa e përvojës në punë, nevoja për t'u kujdesur për anëtarët e familjes, gjendja jashtëzakonisht e keqe financiare, puna joformale, qasja e kufizuar në arsim, mbështetja e kufizuar shëndetësore dhe sociale, mungesa e informacionit të mjaftueshëm për mundësitë, stigmatizimi, mungesa e mundësive të jetesës, dekurajimi etj. Për të kapërcyer barrierat në tregun e punës, duhet të bëhet një plan individual për zhvillimin e karrierës në bashkëpunim me këshilltarët e karrierës.

### Orientimi në karrierë

Orientimi në karrierë<sup>3</sup> është shërbim që lidhet ngushtë me planet individuale të zhvillimit dhe duhet të ndihmojë kategoritë e cenueshme në tregun e punës për të menaxhuar karrierën e tyre dhe për të bërë zgjedhjen e duhur në arsim, trajnim dhe mbi të gjitha në zgjedhjen e profesionit të përshtatshëm.

Orientimi në karrierë duhet të ndikojë në përafrimin e dëshirave të njerëzve me mundësitë që ofron ekonomia lokale. Orientimi në karrierë përfshin aktivitete të tilla si: informacion mbi profesionet dhe shkathtësitë, shtigjet për karrierë, mundësitë e të mësuarit, tendencat dhe kushtet e tregut të punës, programet arsimore, masat dhe shërbimet qeveritare dhe joqeveritare për zhvillimin e karrierës dhe mundësitë e punësimit.

Orientimi në karrierë është një gur themel në integrimin ekonomik, përmes të cilit do të ndikohet mbi aktivitetet për realizimin e:

- Objektivat e të mësuarit gjatë gjithë jetës duke ofruar një bazë të duhur njohurish dhe aftësish për të përmbushur kërkesat e punëdhënësve, si dhe duke promovuar lidhjet e duhura ndërmjet arsimit, trajnimit dhe punës.

---

<sup>3</sup> Në disa shtete termit si “këshillim për karrierën”, “zhvillimin e karrierës”, “informacion për karrierën, këshilla dhe udhëzime”, “këshillim profesional” ose “udhëzim profesional” i referohen gamës së aktiviteteve të përfshira këtu brenda nocionit të orientimit në karrierë.

- Rezultatet në tregun e punës, duke reduktuar mospërputhjen ndërmjet njohurive të tyre dhe kërkesës për punë, duke synuar punësimin më të lehtë të tyre.

Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës përmes bashkëpunimit të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile, institucionet (p.sh. Qendra për punësim, Qendra për punë sociale, shkollat e mesme profesionale lokale, qendrat e arsimit të të rriturve, etj.) dhe punëdhënësit duhet të ofrojnë shërbime të orientimit në karrierë përmes këshilltarët e karrierës.

### Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin

Trajnimi synon të përmirësojë shkathtësitë dhe kualifikimet e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, me qëllim integrimin më të suksesshëm të tyre në tregun e punës. Për personat që kanë shkathtësi të pamjaftueshme për tregun e punës, trajnimi është një masë unike dhe e nevojshme për integrimin afatgjatë ekonomik.

Trajnimet në të cilat do të marrin pjesë personat duhet të dizajnohen sipas kërkesave të tregut të punës. Profesionet për të cilat ka kërkesë për punësim të punëtorëve në rajonin verilindor janë teknik mekanik, teknik ndërtimi, administrator, operator sistemi, teknik kimik, teknik elektroteknik, teknik farmaceutik, shitës, rrobaqepës, këpucar, kamerier, saldator, ndihmës saldator, bravandreqës, shofer kamioni, bukëpjekës, kuzhinier, banakier, punëtor ndërtimi, punëtor bujqësie etj.

Gjithashtu, njerëzit mund të përfshihen në trajnime online, trajnime për zhvillimin e shkathtësive digjitale, praktika, trajnime për gjuhë të huaja etj.

Në rajonin e Komunës së Kumanovës dhe Komunës së Likovës ekzistojnë 20 programe të verifikuara trajnuese përmes të cilave fitohen kualifikimet. Llojet e trajnimeve në nivel lokal në të cilat këta persona mund të marrin pjesë dhe përmes të cilave ata mund të fitojnë kualifikimet dhe shkathtësitë e nevojshme mund të shihen në ueb faqen e Qendrës së Arsimit të të Rriturve në linkun e mëposhtëm Lista e programeve - TIS (cov.gov. mk).

## Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore

Masa e punësimit të subvencionuar paraqet një masë tërheqëse mbështetëse për punëdhënësit, e cila mund të stimulojë kërkesën për punësim të kategorive të cenueshme në tregun e punës, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.

Paga e subvencionuar është masë aktive në Planin operativ për masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit përmes qendrave të punësimit në nivel lokal. Punëdhënësit marrin 19.000 denarë në muaj si subvencion mbi pagën e punëtorit për një periudhë prej 3, 6 ose 12 muaj për punësimin e personave. Mbështetja e përgjithshme financiare për një person për një periudhë 3 mujore është 57.000 denarë; për 6 muaj është 114.000 denarë dhe për 12 muaj është 228.000 denarë. Mjetet paguhen një herë për të gjithë periudhën e subvencionimit, pasi të jetë realizuar punësimi me orar të plotë të punës.

### Vetëpunësimi

Kjo masë është pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022, i cili zbatohet nga Agjencia e punësimit në bashkëpunim me Agjencinë për zhvillimin e ndërmarrësisë. Shpallja për pjesëmarrje në masë publikohet një ose dy herë në vit. Personat që kanë njohuri dhe shkathtësi adekuate dhe që dëshirojnë të hapin biznesin e tyre apo ta formalizojnë atë ekzistues duhet t'i nënshtrohen trajnimit prej 30 orë për ndërmarrësi, të përgatisin një ide biznesi për të përfituar grante për pajisje dhe materiale në vlerë prej 5.000 euro.

## Rekomandime

1. Mënyra më e mirë për integrimin ekonomik të të riatdhesuarve është ofrimi i trajnimeve për profesion dhe punësim, i cili do t'u mundësojë atyre të forcohen ekonomikisht dhe në aspektin social. Komuna e Kumanovës, Komuna e Likovës dhe institucionet e tjera publike duhet t'i ndihmojnë këta njerëz duke plotësuar nevojat themelore ekzistenciale dhe kushtet e jetesës, si dhe t'u ofrojnë mundësi për fillimin e procesit të integritit ekonomik.
2. Përfshirja në kohë në politikat aktive do të rrisë probabilitetin e integritit të tyre ekonomik. Ndërmarrjet me përgjegjësi shoqërore dhe ndërmarrjet sociale nga Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës duhet të përfshihen në shfrytëzimin e mundësive për krijimin e vendeve të punës për këta persona.
3. Integrimi ekonomik është një proces afatgjatë dhe nuk përfundon me punësim. Përfshirja e këshilltarëve lokalë për karrierë nga Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës mund të jetë një hallkë kyçe në aktivizimin, motivimin, informimin dhe orientimin për zhvillimin e karrierës.
4. Për personat që nuk kanë shkathtësi adekuate ose të mjaftueshme, përfshirja në trajnime është e vetmja rrugë drejt integritit ekonomik afatgjatë. Fokusi duhet të jetë në ofrimin e kualifikimeve dhe aftësive profesionale që kërkohen në tregun e punës në rajonin verilindor, për këto profesione: teknik mekanik, teknik ndërtimi, administrator, operator sistemi, operator teknik kimik, teknik elektrik, teknik farmaceutik, shitës , rrobaqepës, këpucar, kamarier, saldator, ndihmës saldator, bravandreqës, shofer kamioni, bukëpjekës, kuzhinier, banakier, punëtor ndërtimi, punëtor bujqësie etj.
5. Inkurajimi i punëdhënësve duke i informuar ata për mundësitë që ofron masa e punësimit të subvencionuar do të mundësojë krijimin e vendeve të punës për kategoritë e cenueshme të qytetarëve, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre. Punëdhënësit që do të punësojnë një të riatdhesuar mund të marrin subvencione në shumë prej 19.000 denarë në muaj, si subvencionim në pagën e të punësuarit për një periudhë prej 3, 6 ose 12 muaj për punësimin e personave nga grupet e synuara.
6. Personat që kanë njohuri dhe afinitete për sipërmarrësi mund të hapin biznesin e tyre, për shembull parukier, estetist, bukëpjekës, marangoz, këpucar, trajnues i gjuhëve të huaja, riparues automjetesh etj., për të cilin do të mbështeteshin me grant në pajisje dhe materiale në vlerën 5,000 euro.
7. Agjencia e punësimit dhe institucionet e tjera që mund të ndikojnë në integrimin ekonomik, kanë akses të kufizuar për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre në tregun e punës dhe për këtë arsye përfshirja e komunitetit lokal, organizatave të shoqërisë civile

dhe sektorit privat lokal mund të jetë efektiv. Komuna e Kumanovës dhe Komuna e Likovës duhet të krijojnë kushte për krijimin e partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile dhe punëdhënësit për trajnimin dhe punësimin e kategorive të cënueshme në tregun e punës, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.